



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.05.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kilovolt Shqipëri – Kosovë (Tiranë – Prishtinë), nëpërmjet një huaje prej 42.000.000 (dyzet e dy milionë) eurosh”. *(komision për dhënie mendimi.)*
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për pranimin e skedulit CXL VI të zgjerimit të listës së marrëveshjes së teknologjisë së informacionit, në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë”. *(komision për dhënie mendimi.)*
3. Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen të projektligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”. *(komision përgjegjës.)*

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Adnor Shameti, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Elena Xhina, Tom Doshi, Ermonela Felaj (Valikaj), Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi.

#### **Mungojnë:**

Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Silva Caka.

#### **Të ftuar:**

Dorina Cinari – Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agim Bregasi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Aurora Vasili - Drejtoreshë e PIU-së nga OST në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Anisa Pina - specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Aldo Xherahu – fotograf në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Erion Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Albana Shkurta – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazgji – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Gavril Lasku – këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Zamir Xhepa – specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Toni Gogu – Zëvendësministër i Drejtësisë

Ardian Shega – Drejtor në Ministrinë e Drejtësisë

Maks Haxhia - Kryetar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë

Rezarta Abdiu – Drejtoreshë e Trajnimit Vazhdues të Avokatëve në Dhomën Kombëtare të Avokatisë

Agnes Bernhard - shefe e misionit EURALIUS

Tedi Dobi – ekspert vendas i EURALIUS-it

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Mirëmëngjes!

Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i mjaftueshëm, sipas Rregullores së Kuvendit, për të vazhduar me rendin e ditës.

Sot kemi tri çështje në rendin e ditës.

E para, shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW-së Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kilovolt Shqipëri– Kosovë (Tiranë – Prishtinë), nëpërmjet një huaje prej 42.000.000 (dyzet e dy milionë) eurosh”.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relatore e këtij projektligji është kolegja Xhina. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë zonja Dorina Cinari, zëvendësministre; zoti Agim Bregasi, drejtor; zonja Aurora Vasili, drejtoreshë e PIU-së nga OST-ja; zonja Anisa Pina, specialiste; zoti Aldo Xherahu, pjesë e stafit.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi zotën Erion Luçi, zëvendësministër dhe zonjën Brikena Jazxhi, specialiste.

Ju lutem, përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, të zënë vendet!

Do t’ju lutesha shkurtimisht për një prezantim ...

**Dhurata Çupi Tyli** – Më falni!

**Ulsi Manja** – Të mbaroj.

Bëni një prezantim të shkurtët të kësaj marrëveshjeje, por, për respekt të opozitës, sepse sot i kemi të gjithë të pranishëm...

**Dhurata Çupi Tyli** – Të gjithë kemi qenë gjithmonë.

**Ulsi Manja** – Në mungesë edhe të mbledhjeve që kanë komisionet e tjera, sot kemi nderin t’i kemi të gjithë prezent.

E ka kërkuar fjalën për procedurë zonja Çupi, por vetëm procedurë nuk do të ketë, është deklarata e orës 10:30 të mëngjesit.

**Dhurata Çupi Tyli** – Lajm i mirë është se ju i prisni këto reagime.

Në fakt, çdo tentativë dhe çdo përpjekje juaja për ta trajtuar mbledhjen e Komisionit të Ligjeve si një komision krejt normal dhe një rutinë të ditës, ju kthen vetëm në qesharakë ju të maxhorancës, sepse Komisioni i Ligjeve nuk mund të funksionojë më si një Komision i Ligjeve dhe si një komision parlamentar i denjë. Për opinionin publik dhe për ju, të nderuar gazetarë që po na ndiqni, në këtë sallë, që konsiderohet Komision i Ligjeve, në këtë pozicion ku sot është ulur zoti Manja, jo shumë kohë më parë ishte ulur vëllai i Agron Xhafajt, që sot është ministër i Brendshëm, Fatmir Xhafaj.

Sot kemi në rendin e ditës miratimin e një marrëveshjeje. Në fakt, prandaj them se ky komision nuk ka legjitimitet sot, sepse para kësaj marrëveshjeje, jo shumë muaj më parë, është miratuar marrëveshja e krimit midis Fatmir Xhafajt, ish-kryetar i Komisionit të Ligjeve, dhe Agron Xhafajt, për ta shpëtuar këtë të fundit nga burgimi.

Nga njëra anë në këtë komision miratohen ligje për të luftuar krimin, ligje antimafie dhe, nga ana tjetër, miratohen dhe trafikohen dispozita ligjore për të shpëtuar vëllanë e ish-kryetarit të Komisionit të Ligjeve. Ky është fakti më tronditës që ka ndodhur në historinë 27-vjeçare parlamentare. Ish-kryetari i Komisionit të Ligjeve trafikon dispozita ligjore. Nuk e kam fjalën për një shkresë të thjeshtë të një zyrtari, për shkresa apo korrespondenca të departamenteve në korridoret parlamentare, por e kam fjalën për dispozitë ligjore në Kodin e Procedurës Penale. Është kjo dispozitë ligjore që e ka trafikuar ish-kryetari i Komisionit të Ligjeve, që sot zëvendësohet nga zoti Manja, që shpëton vëllanë e tij nga burgu.

Nga njëra anë kemi Agron Xhafajn që trafikon drogë në brigjet e Vlorës dhe, nga ana tjetër, Fatmir Xhafajn në brigjet e Komisionit të Ligjeve, që trafikon ligje. Kjo është shumë e turpshme.

Zoti Manja, sot dhe më pas duhet t'i jepni legjitimitetin këtij komisioni. Kërkojani ministrit tuaj të Brendshëm të japë dorëheqjen. Reflektoni të gjithë, sepse jo të gjithë jeni të fajshëm. Këtu, në fakt, ju e reflektoni presionin. Keni një kategori deputetësh të maxhorancës, që janë të pafajshëm dhe reflektojnë frikë dhe turp, dhe një kategori që ka bashkëpunuar me ministrin e Brendshëm për trafikimin e Kodit të Procedurës Penale.

Në fakt, do t'u kërkoja të reflektojnë edhe zonjave deputete të maxhorancës, sepse bëhet fjalë për jetën e fëmijëve, bëhet fjalë për familjet tona, bëhet fjalë për të ardhmen e fëmijëve tanë. Një ministër i Brendshëm, që kryen, dhe tashmë është i dyshuar për konsumimin e disa veprave penale, nuk ka asnjë të drejtë për shqiptarët të drejtojnë Ministrinë e Brendshme.

Merrni masa, zoti Manja, dhe kthejini legjitimitetin Komisionit të Ligjeve. E keni kthyer Komisionin e Ligjeve, e keni kthyer politikën në shërbim të qytetarëve në xhungël. Nuk ka më asnjë shqiptar që sot është me ju, prandaj ditën e shtunë, datë 26 maj ora 11:00, ju ftoj

të gjithë, demokratë dhe socialistë, edhe ju zoti Manja, zonjat deputete të maxhorancës, të rinj e të reja, t'i bashkoheni protestës së datës 26 maj për t'i kthyer legjitimitetin vendit, për ta kthyer Shqipërinë dhe të ardhmen e fëmijëve tanë drejt Europës dhe jo drejt krimit, drogës, korrupsionit, varfërisë dhe mungesës së shpresës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E thashë, një pjesë e maxhorancës është e pafajshme për aferat qeveritare.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Çupi!

Në fakt, kjo është çështje dëshire, por një maxhorancë me 78 vota, në demokraci rrëzohet me votë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

78 mandate. Në votimin e ditës së enjte projektligjet u miratuan me 78 vota. Kjo është demokracia, është çështje numrash. Zgjedhjet u bënë para një viti.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do t'ia jap fjalën për procedurë profesorit. Të respektojmë profesorin pastaj do të vazhdojmë me rendin e ditës.

**Edmond Spaho** – Meqenëse folët për demokracinë, a dini ndonjë demokraci ...?

**Ulsi Manja** – Zoti Spaho, ia kam dhënë fjalën zotit Gurakuqi. Nëse ai e lë fjalën, atëherë mund ta merrni ju.

Zoti Gurakuqi, fjalën e ka marrë nënkryetari i grupit.

**Edmond Spaho** – Unë nuk di ndonjë vend demokratik ku vëllai i ministrit të Brendshëm të jetë i dënuar për krijim të organizatave kriminale dhe për trafik ndërkombëtar të drogës. Nëse ju njihni ndonjë demokraci të tillë, atëherë unë bie dakord, por nuk ka.

Ministri i Brendshëm duhet të japë dorëheqjen në mënyrë që vendi të qëndrojë dinjitoz. Në Partinë Socialiste dhe Rilindje ka njerëz, të cilët kanë moralin për të qenë ministra të Brendshëm. Nuk i takon një njeriu me një cen të tillë të jetë ministër i Brendshëm.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Spaho për sugjerimin miqësor!

Fjalën e ka zoti Gurakuqi.

**Romeo Gurakuqi** – Faleminderit, zoti Manja!

Të nderuar kolegë!

Gjej rastin të jem në Komisionin e Ligjeve të këtij institucioni sovran, para mediave, pranë përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore, për të ngritur një problem thelbësor për punën e komisionit tuaj të nderuar, që prej 2 vitesh ka shkaktuar një situatë vakumi institucional në funksionimin e sistemit të drejtësisë.

Prej disa muajsh, praktikisht në muajin e fundit, vendi ndodhet pa Gjykatë Kushtetuese operative. Ka një sistem gjyqësor që operon me pamjaftueshmëri të kapaciteteve dhe me perspektivë të një përplasjeje dhe zbrazëtie të rëndësishme. Jemi në një situatë tranzicioni në aspektin e kronologjisë së zgjidhjes së problemit, e cila është tërësisht e paqartë.

Njëkohësisht, nëpërmjet këtij komisioni ose personazheve të rëndësishëm, që kanë promovuar këtë komision, është krijuar një shkrimje e aktivitetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe atij të prokurorisë, si një institucion i pavarur, gjë që bie në kundërshtim me pavarësinë e institucioneve. Kush e krijoi këtë situatë në aspektin e vakuimit institucional tranzitor?

Mos vallë reforma në drejtësi është realizuar pa akte tranzitore apo këto akte tranzitore nuk janë menduar në mënyrë të qartë, duke krijuar një vakuum institucional, saqë opozita dhe shoqëria civile të mos kenë një institucion ku të ankohen për ministrin e Brendshëm të këtij vendi, i cili vazhdon të qëndrojë në detyrë edhe pse familjarët e tij akuzohen për trafik droge?

Ju i përmbaheni mbajtjes së ministrit të Brendshëm, kurse në themi se ministri i Brendshëm është në konflikt interesi. Duhet të ekzistojë një institucion për ta zgjidhur këtë, por ai institucion është shkrimje. Pyetja është: kush e ka krijuar këtë situatë?

Më lejoni, të nderuar përfaqësues të medias dhe legjislativit, t'ju bëj me dije se, që nga muaji shtator i vitit 2016, në këtë sallë ka operuar një direktorat i drejtuar nga zoti Fatmir Xhafaj, më pas nga profesoreshë Vasilika Hysi, aktualisht e drejton zoti Ulsi Manja bashkë me zonjën Felaj, që ka krijuar një situatë tranzitore të vakuimit institucional.

Unë kam ardhur këtu jo vetëm si përfaqësues i opozitës, por edhe si përfaqësues i të gjithë brezit të diplomuar në fushën e drejtësisë, që ju duhet ta dëgjoni me shumë vëmendje. Është një situatë e pangjashme që një vend kandidat për në Bashkimin Europian nuk ka Gjykatë Kushtetuese dhe ka një sistem vakuumi në sistemin e drejtësisë. Kjo gjë që ju ngarkon me përgjegjësi, prandaj mendoj se duhet ta vendosni vëmendjen shumë mirë në këtë situatë që keni krijuar.

Në kundërshtim me marrëveshjen e arritur në muajin korrik të vitit 2016 midis pozitës dhe opozitës për reformimin e sistemit të drejtësisë, ky direktorat, me emrat që përmendëm (ministri aktual i drejtësisë është lideri i këtij grupi, i cili ka operuar në një diktat të caktuar në kundërshtim me udhëzimet e dhëna nga partnerët ndërkombëtar), ka krijuar këtë situatë të vakuimit institucional në sistemin e drejtësisë.

Si është e mundur që vendi të operojë në një situatë të tillë kur është kandidat për t'u bërë pjesë e Bashkimit Europian? Ne nuk kemi një arbitër konstitucional që të gjykojë

midis pozitës dhe opozitës, një Gjykatë Kushtetuese që të mbrojë kartën e lirive. Para dy muajve ministri ynë i Brendshëm i kërkoi Policisë së Shtetit të procedojë opozitën për të drejtën e protestës dhe nuk ka institucion që ta mbrojë, me përjashtim të mosveprimit.

Këtu bëhen tri pyetje, të cilave unë mendoj se ju duhet t'u përgjigjeni saktë duke shmangur në mënyrë absolute situatën e krijuar.

Së pari, kemi të bëjmë me paaftësi, kemi të bëjmë me veprim të qëllimshëm për vendosjen në një kaotizëm të tillë të sistemit të drejtësisë apo është një paaftësi për të parashikuar procedurat e ndërmjetme në tranzicionit midis drejtësisë së vjetër dhe drejtësisë së re?

Unë mendoj se janë të tria dhe këtë e provoj me shumë arsye.

Para së gjithash, unë kuptoj se si rezultat i këtij shformimi është krijuar kjo rrethanë e boshllëkut, e vakuimit. Ju e quani të përkohshëm, por unë, çdo shqiptar dhe çdo person që merr vesh nga drejtësia, kupton se nuk ka një, le të themi, agjendë kohore se kur do të përfundojë kjo situatë transitive, ku Kryeministri i vendit kontrollon tërësisht sistemin e drejtësisë, është njëkohësisht edhe hetues, dhe në krye të Ministrisë së Brendshme është një ministër i Brendshëm, i cili ka një familjar (për të dytën herë përsëritet kjo), që është i dyshuar i drejtësisë, njëkohësisht është edhe një person, i cili ka precedent penal dhe ndodhet në vendin fqinj për të kryer dënimin, në një kohë kur nuk ka kryer detyrimet ndaj shtetit shqiptar në aspektin e së drejtës penale.

Është kjo rrethanë, në fakt, që ka çuar që në sistemin transitiv... Unë do të doja të ishin përfaqësuesit e Euralius-it këtu, që duhen ta kenë në vëmendje këtë gjë.

**Ulsi Manja** – Ju lutem, pak qetësi, sa ta përmbyllë fjalën zoti Gurakuqi!

**Romeo Gurakuqi** - Unë do t'ju vë në dukje se për shkak të komandës së këtij direktorati është krijuar një rrethanë e tillë, që nga sekretaria e Ministrisë së Brendshme ose e këtij institucioni, që ka tentuar të bëjë reformën në drejtësi, por e ka çuar vendin në kolaps në aspektin e drejtësisë, kanë dalë përfaqësuesit e drejtimit të Ministrisë së Drejtësisë, që, në fakt, nuk operojnë dhe nuk ushtrojnë funksionin e vet në mbrojtje të ligjshmërisë së këtij vendi dhe në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Kanë dalë edhe, le të themi, përfaqësues të rëndësishëm të komisionerëve të partisë suaj, të cilët praktikisht sot (kontrolloni CV-të, mund t'i gjeni) janë përfaqësues të institucioneve që kryejnë aktet e ndëshkimit ose të dhënies së lejeve të vijimit të punës së punonjësve të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë, domethënë të gjykatësve, të prokurorëve e të tjerë. Janë kandidatë që janë angazhuar me një forcë politike, që sot do të marrin pjesë dhe po përpunojnë të gjithë sistemin e drejtësisë së re.

Domethënë, jemi në një situatë kolapsi, të cilën ju, të nderuar kolegë, nuk duhet ta pranoni dhe duhet të mbani të gjithë përgjegjësinë për ta korrigjuar dhe për të ndëshkuar të gjithë ata që e kanë çuar situatën në këtë gjendje.

Ju faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Gurakuqi!

Në fakt, nëse Komisioni i Posaçëm i Reformës në Drejtësi, i ngritur me vendim të Kuvendit të Shqipërisë, në këndvështrimin tuaj është direktorat, po, unë kam qenë anëtar i atij direktorati, së bashku me kolegen Hysi dhe e kam shumë për nder, bashkë me kolegët e mi të opozitës.

**Romeo Gurakuqi** – Është ngritur për të respektuar marrëveshjen, mbarëvajtjen dhe për të zbatuar me konsensus një situatë, por jo për të vepruar në mënyrë të njëanshme...

**Ulsi Manja** – Faleminderit për fjalën!

Vazhdojmë me rendin e ditës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Çinari, ju lutem, bëni një prezantim të shkurtër të projekt marrëveshjes!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, të bëhemi seriozë!

Tre kolegë të opozitës folën për procedurë. Me gjithë respektin (absolutisht, është e drejta e çdo deputeti për të folur), por kjo loja “për procedurë e për replikë”, nuk... Mos e pengoni komisionin, sepse kemi një agjende punë në komision. Kemi dy projekt marrëveshje shumë të rëndësishme me Gjermaninë. Janë 42 milionë euro që presin votën e këtij Kuvendi për t’i shkuar publikut dhe më duket se po e pengoni punën e komisionit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë tregova gjithë respektin e duhur për të gjithë kolegët e opozitës. Kam detyrimin për të vazhduar me rendin e ditës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Klevis Balliu** – Zoti Manja, kam një pyetje.

**Ulsi Manja** – Po nuk të shkon të flasësh mbas profesorëve, të lutem!

**Klevis Balliu** – Kam katër ditë që kërkoj fjalën...

**Ulsi Manja** – Këtu folën dy profesorë të nderuar, tani e kërkon fjalën ti. S’më duket normale.

**Klevis Balliu** – Kam katër ditë që kërkoj fjalën dhe nuk ma ke dhënë.

**Ulsi Manja** – Zhurma duhet, se ju do të ikni pas zhurmës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*



Zonja Çinari, mund të vazhdoni, shkurtimisht.

Fjala është për ju.

**Klevis Balliu** - Zoti Manja, a ka mundësi të bëj një pyetje?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** - Zonja Çinari, a ka mundësi ta ndezësh mikrofonin?

**Klevis Balliu** – Zoti Manja, a ka mundësi të bëj një pyetje për të gjithë ju anëtarët e maxhorancës, që të jemi edhe të qartë me njëri-tjetrin?

**Albana Vokshi** – Respektoni gratë të paktën!

**Klevis Balliu** – Nuk është serioze, se po bëhemi një tufë me karagjozë këtu. Zhurmë kot më kot!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dua të bëj një pyetje. Më jepni përgjigje dhe jemi dakord pastaj!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Albana Vokshi** – Mos shkel Rregulloren!

**Klevis Balliu** – Zoti Manja, a ka mundësi për procedurë?

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Albana Vokshi** – Po si të vazhdoj?!

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Klevis Balliu** – Zoti Kryetar, a ka mundësi ta marr fjalën? Kam katër ditë që të kërkoj fjalën dhe nuk ma jep. Kaq frikë ke nga një pyetje?! Ku jemi kthyer, të kesh frikë nga një pyetje!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dje ike në drejtim të pa ditur, sot do të bësh lojën e radhës.

Zoti Kryetar, a ka mundësi ta marr fjalën për procedurë?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kaq frike ke nga një pyetje?

**Albana Vokshi** – Ulsi, pse ke frikë të na japësh fjalën?

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Klevis Balliu** - Një pyetje kam: cili nga ju mendon se është normale, që në një vend demokratik (nuk e di fare a ka lidhje Fatmir Xhafaj me drogën dhe as nuk dua ta di), ministri i Brendshëm të ketë një vëlla që të ikë dhe të shërbejë 7 vjet e 2 muaj në burg? Nëse mendoni se kjo është normale, na e thoni dhe po ikim ne. Jemi dakord. Është e thjeshtë situata. Një pyetje po bëj. Çfarë vështirësie ka për të kthyer përgjigje?

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

Kush është dakord në parim...?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, kolegë të shumicës, ngrini dorën!

10 pro në parim. Ka kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Vazhdojmë me nenin 1.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord me nenin 2? 10 pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

**Klevis Balliu** – Në qoftë se mendoni se kjo është normale, po iki.

**Ulsi Manja** – Kush është dakord në tërësi me projekt marrëveshjen? Kundër nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet kjo projekt marrëveshje.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Klevis Balliu** – Edhe para katër vjetëve këtë lojë bënit.

**Ulsi Manja** - Qetësi!

Mos u mërzit!

**Klevis Balliu** – Çfarë qetësie?

Dua të bëj një pyetje dhe të më ktheni përgjigje. Në qoftë se më ktheni përgjigje, dal nga kjo sallë dhe bie dakord me ju. Ta di të paktën se ku jeni!

**Ulsi Manja** – Ju lutem!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.05.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për pranimin e skedulit CXL VI të zgjerimit të listës së marrëveshjes të teknologjisë së informacionit, në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë”.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Adnor Shameti, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Elena Xhina, Tom Doshi, Ermonela Felaj (Valikaj), Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi.

#### **Mungojnë:**

Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Silva Caka.

#### **Të ftuar:**

Albana Shkurta - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Gavril Lasku – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Zamira Xhepa - Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Toni Gogu - Zëvendësministër i Drejtësisë

Adrian Shega – drejtor në Ministrinë e Drejtësisë

Maks Haxhia - Kryetar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë

Rezarta Abdiu – Drejtoreshë e Trajnimit Vazhdues të Avokatëve në Dhomën Kombëtare të Avokatisë

Agnes Bernhard - Shefe e misionit EURALIUS

Tedi Dobi - Ekspert vendas i misionit EURALIUS

**Ulsi Manja** - Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës...

**Klevis Balliu** – Po ç’pikë e dytë e ç’pikë e tretë?! Pika që s’ju bie juve!

**Ulsi Manja** - ...me shqyrtimin e projektligjit “Për pranimin e skedulit CXL VI të zgjerimit të listës së marrëveshjes të teknologjisë së informacionit, në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë”.

Komisioni ynë është komisioni për dhënie mendimi.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Sa bukur këndon! Ke 3 ditë që këndon te Komisioni i Ligjeve, u kënaqe?!

**Klevis Balliu** – A ka më bilbil se ty?! Keni 8 vjet që po bëni bilbilin!

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Unë po bëj pyetjen më të thjeshtë sot për këtë maxhorancë: a jeni dakord që ministri i Brendshëm të ketë vëllanë në burg dhe ai të qëndrojë ende si ministri Brendshëm? A jeni dakord ju që një polic të largohet nga vendi i punësisë paska një kushëri që gjoja u marrka me drogë, kurse ministri i Brendshëm, që ka vëllanë që merret me drogë, qëndron ende si ministër?!

**Ulsi Manja** - Të ftuar nga Ministria e Financave janë zëvendësministria, zonja Albana Shkurta, zoti Gavril Lasku, këshilltar, si dhe zonja Zamira Xhepa, specialiste.

Përfaqësuesit e ministrisë të zënë vendet dhe sapo zoti Balliu të mbarojë këngën e ditës, ju lutem, mund të flisni shkurtimisht për projekt marrëveshjen.

Relatori, zoti Çyrbja, a jeni dakord me projektligjin?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Klevis Balliu** – Zoti Ulsi, asnjë komision nuk do të vazhdojë punën në normalitet derisa t’i përgjigjeni pyetjes! Pse nuk i përgjigjeni pyetjes? Pse jeni bërë të gjithë memecë? Ju jeni një maxhorancë bojkoti! Ju nuk thoni asgjë tjetër, ose largoheni siç u larguat dje, ose bëni memecin! Në qoftë se doni të bëni memecin, ikni dhe shqyrtojeni në vend tjetër projektligjin, sepse këtu duhet të jepni përgjigje, duhet të jepni llogari dhe jo atë llogaridhënien që bëni...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Një ish-ministër e keni në arrest shtëpie, një monist e ka vëllanë në burg, kështu që jepni një përgjigje, zotëri!

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Më jepni një përgjigje dhe unë do ta mbyll!

Si nuk jepni një përgjigje me “po” ose “jo”: a ju duket normale që një ministër ta ketë vëllanë në burg për drogë dhe bëhet fjalë për drogë të klasit A?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Jurgis Çyrbja** – Zoti kryetar, në këto kushte jam dakord me propozimin e projektligjit.

**Ulsi Manja** - Edhe relatori është dakord me propozimin e projektligjit “Për pranimin e skedulit CXL VI të zgjerimit të listës së marrëveshjes të teknologjisë së informacionit, në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë”.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Unë po bëj detyrën që më ka ngarkuar Kuvendi i Shqipërisë.

**Klevis Balliu** – Ju jeni një maxhorancë memece, që nuk i ktheni dot përgjigje pyetjes më të thjeshtë: a ju duket normale që ministri i Brendshëm ta ketë vëllanë që merret me drogë?

**Ulsi Manja** - Vazhdojmë me miratimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

**Klevis Balliu** – Jep përgjigje!

Të kanë dhënë urdhër të mos flasësh? Urdhrat zbatoji!

**Ulsi Manja** – Për ty jam i zënë.

**Klevis Balliu** – Zbatoji urdhrat!

**Ulsi Manja** – Atyre që flasin shqip dhe si shqiptarë, ua dhashë fjalën.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Klevis Balliu** – Jepni përgjigje!

**Ulsi Manja** – Hedhim në votim në tërësi ...

**Klevis Balliu** – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. E miratove ti, bravo!

**Ulsi Manja** – Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit “Për pranimin e skedulit CXL VI të zgjerimit të listës së marrëveshjes të teknologjisë së informacionit, në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë”.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Klevis Balliu** – Jeni gjithë ky burrë dhe nuk ktheni dot një përgjigje!

**Ulsi Manja** – Për çfarë duhet t’jua kthej përgjigjen?

**Klevis Balliu** – Deri në këtë pikë ka degraduar maxhoranca! Një maxhorancë memece...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

A ka mundësi të ktheni një përgjigje?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** – A je krenar ti për një njeri të opozitës, që akuzohet për vjedhjen e 250 milionë eurove?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Klevis Balliu** – Ulsi, më ktheni një përgjigje: a jeni dakord që ministër i Brendshëm të jetë një person, vëllai i të cilit është marrë me drogë, “po” apo “jo”? Kaq dua unë të di! A është ndonjëri këtu që mund të më japë një përgjigje?

Sa deputetë jeni ju këtu? Jeni 10 deputetë...

*(Diskutime pa mikrofon.)*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.05.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen i projektligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Adnor Shameti, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Elena Xhina, Tom Doshi, Ermonela Felaj (Valikaj), Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi.

#### **Mungojnë:**

Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Silva Caka.

#### **Të ftuar:**

Toni Gogu - Zëvendësministër i Drejtësisë

Adrian Shega – Drejtor në Ministrinë e Drejtësisë

Maks Haxhia - Kryetar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë

Rezarta Abdiu – Drejtoreshë e Trajnimit Vazhdues të Avokatëve në Dhomën Kombëtare të Avokatisë

Agnes Bernhard - Shefe e misionit EURALIUS

Tedi Dobi - Ekspert vendas i misionit EURALIUS

**Ulsi Manja** – Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, me shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni ynë është komision përgjegjës.

**Klevis Balliu** – A do ma jepni përgjigjen për pyetjen, apo jo?

**Ulsi Manja** – Pushoni se më shurdhuat!

**Klevis Balliu** – Për çfarë u shurdhove ti?! Ti u ke nxirë jetën shqiptarëve...

**Ulsi Manja** – Ka 3 ditë që e ka marrë vesh opinionin publik që jeni deputet.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Klevis Balliu** – Ulsi, a ka mundësi të më kthesh përgjigje për këtë dhe unë e mbyll. Unë nuk e di nëse Fatmir Xhafaj ka lidhje me drogën dhe as nuk më intereson, por a mund të më thuash: a është normale, në një vend demokratik, që ministër i Brendshëm të jetë një peron, i cili vëllanë e tij e ka në burg?

**Ulsi Manja** – Do ta jap unë përgjigjen: e ka dhënë opinionisti Fahri Balliu përgjigjen.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Klevis Balliu** – Ka një gjë: ne këtu jemi të gjithë shqiptarë...

**Ulsi Manja** – Nga Ministria e Drejtësisë ka konfirmuar pjesëmarrjen zëvendësministri, zoti Toni Gogu dhe zoti Adrian Shega, drejtor. Nga Dhoma Kombëtare të Avokatisë ka konfirmuar pjesëmarrjen kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, zoti Maks Haxhia

Ju lutem mund të zini vendet!

**Klevis Balliu** – Zoti Ulsi, a ka mundësi të jepni një përgjigje?

**Ulsi Manja** – Nga misionit EURALIUS kanë konfirmuar pjesëmarrjen shefja e misionit, zonja Agnes Bernhard, dhe eksperti vendas, zoti Tedi Dobi.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Klevis Balliu** – Si thatë?! Të pyes babanë tim?! Unë po pyes kryetarin e Komisionit të Ligjeve. Atëherë, ikni ju të gjithë, që të vijë babai im këtu!

*(Diskutime pa mikrofon.)*

A e kuptoni se deri ku ka arritur niveli?! Ju përmendni emra familjarësh! Si ju vjen juve t'ju përmend unë emrat e familjarëve këtu?

**Ulsi Manja** – E kemi lënë te nenin 14.

Zoti Shameti, relatori i projektligjit bashkë me zotin Haxhia...

**Klevis Balliu** – Si nuk kthen asnjëri përgjigje?! Çfarë jeni ju?! Ju jeni qeveri memece, maxhorancë memece, deputetë memecë, maxhoarncë bojkoti!



**Adnor Shameti** – Është e rëndësishme të informoj komisionin se varianti i paraqitur për nenin 14 është formuluar në bashkëpunim me zyrën e EURALIUS-it, me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, si dhe me Ministrinë e Drejtësisë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** - Po, zoti Hyseni.

**Klevis Balliu** – Pse të gjithë deputetë tuaj e marrin fjalën për procedurë dhe nuk e marrin deputetët tanë.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Alket Hyseni** - ....duke qenë se ligji për avokatinë është një ligj shumë i rëndësishëm, i cili kërkon qetësi, konsultë, diskutim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë do të dëshiroja që opozita të ishte pjesë e këtij diskutimi dhe për këtë arsye...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Meqenëse ka ndryshime të mëdha, unë kërkoj shtyrjen e diskutimit për mbledhjen tjetër.

**Ulsi Manja** – Zoti Hyseni, faleminderit, për sugjerimin, por projektligjet në Kuvend nuk mund të jenë çështje e opozitës, kështu që do të vazhdojmë me rendin e ditës!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk aprovohet kërkesa për procedurë.

**Klevis Balliu** – A ka mundësi të marrë fjalën opozita?

**Ulsi Manja** – Është çështje e rendit të ditës, por nuk hidhet ne votim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Klevis Balliu** – A ka mundësi të marr fjalën, more zotëri? Më jep fjalën për procedurë, që e kam kërkuar prej 4 ditësh. Nuk ju vjen turp! Kam 4 ditë që kërkoj fjalën këtu për të bërë një pyetje dhe se bëj dot, se nuk të lë njëri të flasësh, se jeni bërë maxhorancë memecësh, ecni rrugës me kokën poshtë dhe nuk guxonit të ngrini zërin.

A ka mundësi ta marr fjalën?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Enkelejd Alibeaj** – Është çështje fjale, jepi të drejtën të flasë, pastaj numrat për të votuar ju i keni, thoni çfarë të doni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po ky nuk jep fjalën, le të japë fjalën, pastaj vazhdoni historinë tuaj!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

*(Rifillon mbledhja)*

**Ulsi Manja** – Rifillojmë mbledhjen e komisionit me projektligjin “Për avokatinë”.

Jemi te shqyrtimi nen për nen i projektligjit.

Jemi te neni 14 i projektligjit.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ju lutem, zoti Shameti, si relator!

**Adnor Shameti** - Faleminderit!

Duke qenë se në bashkëpunim ...

*(Diskutim pa mikrofon)*

Kjo mbledhje të shtyhet për ditën e hënë që të kemi rakorduar mendimet në lidhje me kushtet dhe kriteret për të plotësuar për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë.

Meqë ditën e premte është takimi përmbyllës në lidhje me provimin e shtetit nuk mund të vazhdojmë me dispozitat e tjera të ligjit.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Fjalën e ka nënkryetari i komisionit për procedurë.

**Enkelejd Alibeaj** – Meqë ka një propozim nga ana juaj që ta shtyni, se siç duket kështu e keni marrë këtë punë shtyj e shtyj. Njëri ikën, tjetri fshihet, njëri nxjerr gazetarët jashtë, tjetri nuk u jep fjalën deputetëve të opozitës. Ju keni marrë përsipër sot të diskutoni edhe ligjin “Për avokatinë” dhe me ç’kuptoju edhe duke trafikuar edhe dispozita, doni të vendosni edhe ca dispozita që pengojnë atë, të cilët dalin jashtë vetingut, të mos ushtrojnë edhe avokatinë. Pse nuk e bëni këtë gjë edhe për ministrin e Brendshëm?

Meqë po flisni në pozita morale, është e ligjshme, është e moralshme të diskutohet sot, këtu, çështja e moralitetit politik të kreut të rendit dhe të sigurisë së këtij vendi, ministrin të Brendshëm.

Për këtë arsye, mirë është që mos ta shtyni diskutimin e këtij ligji, por ta diskutojmë duke zbatuar Rregulloren dhe të gjithë këta që janë deputetë, edhe ata të anës tjetër, kanë të drejtën të diskutojnë sipas Rregullores dhe të shprehin atë çfarë mendojnë për ligjin dhe jo vetëm, si dhe për çështjet më sensitive, të cilat sot prekin të gjithë shqiptarët.

Propozimi është që të mos shtyhet procedura, por të vazhdojmë të diskutojmë të gjithë, sepse ka nevojë edhe publiku të marrë vesh. Ligjet të bëra në mënyrë okulte, siç i keni bërë zakon tashmë, duke trafikuar dispozita.

Mirë është të mos i merrni përsipër, sepse shkelni Rregullore, mbi të gjitha, shkelni edhe Kodin Penal. Prandaj të vazhdohet procedimi në Komision të Ligjeve ndaj ju lutem, kryetar, kjo sallë nuk është e juaj, e asnjërit prej jush dhe e asnjërit prej nesh. Është e publikut,

i cili do të kuptojë se ç'ndodh me njerëzit e zgjedhur, çfarë qëndrimi mbajnë të zgjedhurit e tyre për një çështjet kaq të rëndë: qeveritarë të përfshirë në krim, vëllezërit e tyre të dënuar, ndaj duan të dinë se çfarë qëndrimi mbajmë ne, që jemi betuar mbi Kushtetutë e jemi përgjëruar për ta se do të bëjmë ligje të mira, do të bëjmë moralitetin, por sot është dita e llogaridhënies e gjithsecilit prej nesh.

Ky është propozimi im.

**Ulsi Manja** – Ka dy propozime. Një për të vazhduar mbledhjen dhe propozimi tjetër i relatorit, që e lidh me ditën e premtë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kush është pro propozimit të nënkryetarit të komisionit për të vazhduar mbledhjen?

Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet.

Relatori, zoti Shameti, propozon shtyrjen e mbledhjes, për shkak të provimit të shtetit, ditën e premtë.

Kush është pro që ta shtyjmë këtë pikë të rendit të ditës?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Shtyhet mbledhja.

Këtu e mbyllim mbledhjen e komisionit

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

**MBYLLET MBLEDHJA**

